



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Stilistikë e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite, 40 orë mësimore, 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti të jetë i aftë të njohë stilet e ndryshme gjuhësore, elementët gjuhësorë me vlerë stilistikore, si dhe të përdorë me saktësi figurat retorike

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Të përcaktojë vlerat stilistikore dhe nuancat aspektore të kategorive gramatikore në tekste të ndryshme
2. Të identifikojë kuptimet konotative në fjali, që i japin kësaj të fundit vlerë stilistikore
3. Të përcaktojë nuancat aspektore të fjalëve në fjali
4. Të përcaktojë figurat retorike në tekstet letrare.

Rezultate të pritshme:

1. Njeh dhe identifikon me saktësi figurat retorike
2. Njeh dhe përdor me saktësi stilet e ndryshme gjuhësore
3. Ka shtuar ndjeshëm njohuritë rreth përdorimit të gjuhës, sidomos asaj të shkruar.